



Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 110/21), nenet 65-ç, paragrafi (3) dhe 65-d, paragrafi (1) i Ligjit për Banka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 101/19 dhe 122/21), dhe pika 11) dhe 14) nga Vendimi për metodologjinë për përcaktimin e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 26/17 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.98/21 dhe 149/21) Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për lartësinë e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të ekspozimeve ndaj vendeve të tjera

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 83/22)

1. Përcaktohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lartësi prej 0%.

Lartësia e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nga paragrafi 1) i kësaj pike përcaktohet në bazë të vlerësimit të rregullt të nevojës për të mos futur, futur, rritur, zvogëluar ose gliruar shtresën mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i realizuar në bazë të të dhënave për tremujorin e katërt të vitit 2021 në përputhje me pikën 8) të Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e shkallës së shtresa mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Vendimi) dhe për treguesit e përcaktuar në pikën 10 të Vendimit.

2. Përcaktohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve ndaj vendeve të tjera përcaktohet në lartësi prej 0%.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nga paragrafi (1) i kësaj pike, janë marrë parasysh normat e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të përcaktuara nga autoritetet kompetente të vendeve të tjera dhe lartësia e ekspozimeve të bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndaj klientëve nga sektori privat nga të gjitha vendet ndaj të cilave kanë ekspozim.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon se qeni i vlefshëm Vendimi për lartësinë e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të ekspozimeve ndaj vendeve tjera ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 284/21).

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V nr. 02-15/V-3/2022
31 mars 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска